

20131643967

## KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në përputhje me nenin 75 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë dhe Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nxjerrin

### **NJË DEKRET PËR SHPALLJEN E LIGJIT “PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN PËR ARMËT”**

Shpallet ligji “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët”,  
i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e zhvilluar në datën 21  
nëntor 2013

Numër 07-4587/1  
21 nëntor 2013  
Shkup

President  
i Republikës së Maqedonisë,  
**Gjorgje Ivanov**, nënshkrimi

Kryetar  
i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë  
**Trajko Veljanoski**, nënshkrimi

### **LIGJ “PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN PËR ARMËT”**

#### Neni 1

Në ligjin “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 7/2005, 47/2006, 42/2007, 86/2008, 72/10, 158/11 dhe 119/13), neni 14 ndryshohet si në vijim:

“Pajtueshmëria me kërkesat e nenit 9 paragrafi 1 pika 6 të këtij ligji kontrollohet përmes dhënies së një provimi profesional.

Para provimit profesional i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, personi fizik që kërkon të pajiset me autorizim për mbajtje arme, paraprakisht kryen aftësim praktik për përdorimin e armës.

Aftësimin praktik për përdorimin e armës e kryejnë subjektet e licencuara.

Autorizimin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, e lëshon organi përgjegjës për subjektin ligjor që ka marrë leje për ndërtimin e një poligoni civil qitjeje.

Për kryerjen e aftësimin praktik për përdorimin e armës, subjekti i ligjor i autorizuar ka për detyrë të lëshojë një dëshmi të veçantë.

Dispozita e paragrafit 2 të këtij neni nuk i referohet personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura, personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, punonjësit e strukturës speciale operacionale të cilët kanë shërbyer në polici për jo më pak se tre vjet, punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të dalë në pension, punonjësit e shërbimit të sigurisë në institucionet penitenciare dhe punonjës të tjerë të organeve shtetërore të cilët përmes dispozitave të veçanta janë të autorizuar për mbajtjen e armëve të atij lloji.

Aftësimi praktik për përdorimin e armës kryhet në subjektin juridik të autorizuar nga lektorë dhe instruktorë që kanë mbaruar arsimin e lartë, si dhe ndihmës instruktorë që të paktën kanë kryer arsimin e mesëm.

Instruktorët dhe ndihmës instruktorët e përmendur në paragrafin 6 të këtij neni plotësojnë

kushtet e nenit 9 paragrafi 1 pika 1,2,3,4,6 dhe 7 të këtij ligji.

Ministri i Punëve të Brendshme miraton aktet nënligjore për kërkesat minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet e subjekteve juridike për aftësimin praktik për përdorimin e armës, si dhe për Programin e Trajnimit për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e duhur të armës, mënyrën e realizimit të aftësimin praktik për përdorimin e armës, si dhe mënyrën e realizimit të provimit profesional për të kontrolluar njohuritë teknike për përdorimin e drejtë të armës dhe njohuri të rregulloreve për armët.

#### Neni 2

Pas nenit 14 shtohen nenet 14-a, 14-b, 14-c, 14-d, 14-e, 14-f, 14-g, 14-h dhe 14-i me këtë përmbajtje:

#### “Neni 14-a

Aftësimi praktik për përdorimin e armës realizohet në përputhje me Programin e Trajnimit për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e duhur të armës.

#### Neni 14-b

Pas aftësimin praktik për përdorimin e armës jepet provimi profesional në ambientet e subjektit të autorizuar që ka kryer aftësimin praktik të kandidatit për dhënien e provimit profesional.

Provimi profesional jepet përpara komisioneve të krijuara nga Ministri i Punëve të Brendshme.

Komisionet përbëhen nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

Kryetari dhe zëvendësi i tij/saj janë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, anëtari i dytë dhe zëvendësi i tij/saj janë përfaqësues të subjektit ligjor të autorizuar ku është kryer aftësimi praktik dhe anëtari i tretë i komisionit dhe zëvendësi i tij/saj është specialist IT-je i subjektit ligjor të autorizuar.

Anëtarët e komisionit kanë të drejtën e kompensimit vjetor të shpenzimeve të kryera për realizimin e provimit në vlerën që nuk e tejkalon shumën e tre pagave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë vitin e kaluar të shpallura nga Zyra Shtetërore e Statistikave, të cilat mbulohen nga subjekti ligjor i autorizuar.

Shpenzimet për aftësimin praktik dhe provimin mbulohen nga kandidati.

#### Neni 14-c

Provimi profesional përbëhet nga dy pjesë:

- pjesa e parë teorike, me të cilën kontrollohen njohuritë teorike të kandidatit
- pjesa e dytë praktike, me të cilën kontrollohen aftësitë praktike të kandidatit.

Pjesa e parë teorike e provimit profesional përfshin:

- 1) ligjin “Për armët”;
- 2) Kodin Penal;
- 3) ndihmën e parë dhe
- 4) njohuri teorike për përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontim, montim, pastrim dhe mirëmbajtje të armëve dhe municioneve).

Pjesa e dytë praktike e provimit profesional përfshin:

- 1) njohuri praktike për përdorimin e sigurt të armëve dhe municioneve (çmontim, montim, pastrim dhe mirëmbajtje të armëve dhe municioneve) dhe
- 2) realizim të qitjeve me armë

Pjesa teorike e provimit profesional jepet në formë elektronike duke iu përgjigjur një numri të caktuar pyetjesh..

#### Neni 14-d

Subjekti ligjor i autorizuar tek i cili kandidati ka kryer aftësimin praktik përgatit pyetjet për pjesën teorike të provimit profesional.

Verifikimin e pyetjeve për pjesën teorike të provimit profesional e kryejnë komisionet e përmendura në nenin 14-b paragrafi 2 të këtij ligji.

Komisionet e përmendura në nenin 14-b paragrafi 2 të këtij ligji kontrollojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave të pyetjeve, të paktën një herë në vit.

Gjatë kontrollit, komisionet e përmendura në nenin 14-b paragrafi 2 të këtij ligji, në mënyrë të veçantë duhet të kenë parasysh ndryshimin e dispozitave ligjore të cilat përmenden në pyetje, numrin e kandidatëve që janë përgjigjur, përgjigjet e sakta, si edhe kritere të tjera që mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së bazës së të dhënave të pyetjeve.

Në bazë të kontrollit dhe përditësimit të bazës së të dhënave të pyetjeve, komisioni i përmendur në nenin 14-b paragrafi 2 të këtij ligji vendos nëse pyetjet do të ndryshohen apo do të hiqen nga baza e të dhënave.

#### Neni 14-e

Provimi profesional zhvillohet në një ambient të përcaktuar për dhënien e provimit, i cili është posaçërisht i pajisur me materiale teknike dhe informatike, linjë interneti dhe pajisje të tjera që janë të nevojshme për regjistrimin e provimit.

Zhvillimi i provimit regjistrohet dhe transmetohet direkt në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe në rastet kur regjistrimi ndërpritet për shkaqe teknike, ai regjistrohet dhe regjistrimi i plotë vendoset në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kriteret lidhur me kushtet e ambientit dhe pajisjet teknike dhe informatike me të cilat është pajisur ambienti i përcakton Ministri i Punëve të Brendshme.

#### Neni 14-f

Përpara nisjes së provimit, kryetari i komisionit kontrollon identitetin e kandidatit nëpërmjet kartës së tij/saj të identitetit.

Gjatë zhvillimit të provimit, kandidatit nuk i lejohet të përdorë ligje, ligje me komente dhe shpjegime, telefon celular, kompjuter portativ apo mjete të tjera teknike dhe informatike ose materiale të përgatitura paraprakisht, atij nuk i lejohet komunikimi me kandidatët ose personat e tjerë përveç se me specialistin e IT-së që ndodhet në komision vetëm në rastet kur ai has probleme teknike me kompjuterin.

Në rastet kur kandidati gjatë provimit vepron në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni, ai përjashtohet nga provimi dhe vlerësohet se nuk e ka kaluar atë, kjo gjë pasqyrohet edhe në raportin që jepet bashkangjitur për arritjet e pjesës teorike të provimit të dhënë.

#### Neni 14-g

Provimi fillon me dhënien e pjesën teorike dhe kandidatët që e kalojnë atë i nënshtrohen pjesës praktike të provimit.

Pjesa teorike e provimit përfshin të gjitha fushat e përmendura në nenin 14-c paragrafi 2 të këtij ligji, dhe është e përbërë me nga dhjetë pyetje me qarkim për çdo fushë, të gjitha pyetjet janë me nga tre alternativa ku njëra është e saktë, njëra është e ngjashme dhe njëra nuk është e saktë.

Që provimi të konsiderohet pjesërisht i kaluar, kandidati duhet t'i jetë përgjigjur saktë së paku 75% të pyetjeve në të paktën katër fusha.

Në rastet kur kandidati e kalon pjesërisht pjesën teorike të provimit, ai mund të japë provim përmirësues për kalimin e plotë të provimit profesional jo më vonë se 6 muaj nga data e fillimit të aftësimin praktik për përdorimin e armëve.

#### Neni 14-h

Dhënia e pjesës teorike të provimit profesional bëhet me përgjigjen e një sërë pyetjesh në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter, në pajtim me udhëzimet për mënyrën e zgjidhjes së tij, për të cilin kryetari i komisionit të përmendur në nenin 14-b paragrafi 2 të këtij ligji jep sqarime para nisjes së provimit.

Pyetjet e testit, në varësi të nivelit të tyre të vështirësisë, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

Pyetjet e testit për pjesën teorike dhe përgjigjet e tyre ruhen në një sistem unik elektronik për dhënien e provimit profesional të cilin e vendos dhe e mirëmban subjekti ligjor i autorizuar.

Sistemi elektronik i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni përmban një bazë të dhënash të aksesueshme prej së paku 300 pyetjesh nga fushat e përmendura në nenin 14-c paragrafi 2 i këtij ligji.

Sistemi elektronik për dhënien e provimit profesional nuk mund të lejojë teste elektronike të njëjtë për më shumë se një kandidat.

Sistemi elektronik përmban dhe referenca për aktet dhe literatura ligjore tek të cilët përmbahen përgjigjet e pyetjeve.

Rezultatet e provimit profesional bëhen të disponueshme për kandidatin në kompjuterin ku ai e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

Kohëzgjatja e përcaktuar për përgjigjen e pyetjeve në testin e provimit profesional është 30 minuta për secilën nga fushat e përmendura në nenin 14-c paragrafi 2 i këtij ligji.

#### Neni 14-i

Testet përdoren dhe i jepen kandidatit vetëm në momentin e dhënies së provimit.

Materialet dhe regjistrimet e provimit profesional ruhen pranë subjektit ligjor të autorizuar.

Për kontrollin e provimeve profesionale, Ministri i Punëve të Brendshme formon një komision të posaçëm.

Komisioni i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni përbëhet nga një kryetar, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

Komisioni i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni i përdor materialet dhe regjistrimet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni”.

#### Neni 3

Pas nenit 83-d shtohet neni 83-e me këtë përmbajtje:

#### “Neni 83-e

Një gjobë prej 4000 deri në 5000 euro ekuivalente në dinarë do t’i ngarkohet subjektit të autorizuar që teknikisht kryen provimin profesional nëse nuk e regjistron dhe nuk e transmeton atë direkt në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nëse nuk e vendos regjistrimin e plotë të provimit në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përputhje me nenin 14-e të këtij ligji”.

#### Neni 4

Akti nënligjor i parashikuar në nenin 14-e paragrafi 3 të këtij ligji do të miratohet brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 5

Procedurat e nisura për dhënien e provimit profesional deri në ditën e hyrjes në fuqi të

këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të akteve me të cilët kanë filluar.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, dhe do të fillojë të zbatohet brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi e tij.